

**GJYKATA E APELIT**  
**PRISHTINË**

---

**Numri i lëndës:** PAKR 234/14  
**Më:** 25 qershor 2015

**Gjykata Themelore:** Gjilan, PKR 529/13

Originali: në gjuhën angleze

---

Gjykata e Apelit, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit kosovar të Gjykatës së Apelit Xhevdet Abazi, si kryetar i kolegjit dhe anëtarëve të kolegjit, gjyqtares kosovare të Gjykatës së Apelit Tonka Berishaj dhe gjyqtarit të të EULEX-it pranë Gjykatës së Apelit Roman Raab, si gjyqtar raportues, të asistuar nga Alan Vasak, zyrtar ligjor i EULEX-it, në cilësinë e procesmbajtësit,

Në lëndën e cila ka të bëjë me të pandehurit:

**B.S., emri i babait Q., ..., shqiptar i Kosovës,**

**H.K., emri i babait M., ..., shqiptar i Kosovës,**

Të akuzuar me aktakuzën PPS 57/2011 të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), të ngritur më 29 dhjetor 2011 dhe të konfirmuar më 1 mars 2012 (KA 1/112), për këtë veprim:

Që gjatë vitit 2009, në veçanti në çerekun e fundit të këtij viti, në cilësinë e personit zyrtar – B.S. si kryetar i komunës së Kamenicës ndërsa H.K. si drejtor i prokurimit në komunën e Kamenicës, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për veten ose për dikë tjetër, ose për organizatën afariste apo për t'i shkaktuar dëm personit tjetër, kanë shpërdorur pozitën e tyre zyrtare, i kanë tejkualuar kompetencat e tyre dhe nuk i kanë përmbushur obligimet e tyre zyrtare në rastet kur kanë marrë disa vendime për shpërndarjen e ndihmave për të varfër të cilat ata i kanë shpërndarë gjatë kohës së fushatës së zgjedhjeve vendore të vitit 2009 në Kosovë dhe në komunën e Kamenicës, pa pasur kërkesa nga personat e varfër; duke i tejkualuar shpenzimet për karburante të përcaktuara nga Kuvendi Komunal; duke marrë karburante me paratë e Bordit të Komunës edhe për veturat private të personave të cilët nuk ishin të punësuar në komunë, duke bërë shpenzime për pije dhe ushqime të cilat në disa raste i kanë tejkualuar shpenzimet e aprovuara nga Kuvendi Komunal; shpenzime gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2009 edhe për vikendet kur komuna nuk kishte punuar fare, madje edhe në ditën e

zgjedhjeve; për reklamat e kandidatëve të cilët po bënin gara për kryetar të komunës dhe për anëtarë të Asamblesë Komunale të Kamenicës; në rastet e formimit të komisioneve të ndryshme për vlerësim të ofertave dhe kontroll teknik dhe pranim të punëve të kryera, duke i caktuar kandidatët e njëjtë në dy komisione të të njëjtit tender; duke i shkelur në këtë raste dispozitat në fjalë por duke shkelur edhe Ligjin mbi qeverisjen lokale dhe Ligjin mbi menaxhimin e fondeve publike, duke i shkaktuar palës së dëmtuar – komunës së Kamenicës një dëm prej 178.280,88 eurosh,

Veprimet të cilat janë klasifikuar si vepër penale e:

Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit në kundërshtim me nenin 339 §1, 2 dhe 3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), lidhur me nenin 23 të KPPK-së,

Të gjykuar në shkallën e parë nga Gjykata Themelore e Gjilanit me aktgjykimin PKR 529/13, të datës 20 nëntor 2013, me të cilin B.S. dhe H.K. ishin liruar nga akuza e shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit pasi që nuk ishte provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ata e kishin kryer veprën e përmendur më sipër,

Duke e shqyrtuar ankesën e parashtruar nga PSRK-ja kundër aktgjykimit në fjalë,

Pas marrjes parasysh të propozimit të prokurorit të apelit të shtetit,

Pas mbajtjes së seancës më 25 qershor 2015;

Pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit më 25 qershor 2015;

Duke vepruar sipas neneve 389, 390, 391, 394, 398 dhe 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP);

E merr këtë:

---

## AKTGJYKIM

---

**I. Refuzohet si e pabazë ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Gjilanit PKR 529/13 të datës 20 nëntor 2013.**

**II. Vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Gjilanit PKR 529/13 i datës 20 nëntor 2013.**

## ARSYETIM

---

### I. PROCEDURA E DERITANISHME

Më 29 dhjetor 2011, PSRK-ja ka ngritur në Gjykatën Themelore të Gjilanit, aktakuzën PPS 57/2011 kundër të pandehurve B.S. dhe H.K. për veprën penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit, në kundërshtim me nenin 339, §1, 2 dhe 3 të KPPK-së, lidhur me nenin 23 të KPPK-së.

Më 1 mars 2012, gjyqtari për konfirmimin e aktakuzës i Gjykatës së Qarkut të Gjilanit e ka konfirmuar aktakuzën e përmendur më sipër kundër të akuzuarve B.S. dhe H.K. përmes aktvendimit KA 1/12. Gjatë seancës së konfirmimit, të pandehurit janë deklaruar të pafajshëm. Me aktvendimin e datës 25 shkurt 2013, Gjykata e Apelit i ka refuzuar si të pabaza ankesat në emër të të pandehurve B.S. dhe H.K..

Shqyrtimi gjyqësor kundër të pandehurve ka filluar më 25 shtator 2013. Të pandehurit e kanë mbrojtur qëndrimin e tyre lidhur me akuzat dhe janë deklaruar të pafajshëm.

Shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar më 28 dhe më 30 tetor 2013, më 19 dhe 20 nëntor 2013 me shpalljen publike të aktgjykimit më 20 nëntor 2013, me të cilin të akuzuarit B.S. dhe H.K. janë liruar nga akuza e shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit pasi që kjo akuzë nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ata e kishin kryer veprën e përshkruar më lart.

Të pandehurit B.S. i është dërguar aktgjykimi me shkrim më 20 shkurt 2014 dhe i pandehuri nuk ka parashtruar ankesë.

Të pandehurit H.K. i është dërguar aktgjykimi me shkrim më 20 shkurt 2014 dhe i pandehuri nuk ka parashtruar ankesë.

PSRK-së i është dërguar aktgjykimi me shkrim më 13 shkurt 2014 ndërsa PSRK-ja e ka pranuar të njëjtën ditë më 13 shkurt 2014, kurse ankesë ka parashtruar më 25 shkurt 2014.

Të pandehurit nuk kanë ushtruar ankesë.

Më 24 prill 2014, lënda në fjalë është bartur në Gjykatën e Apelit për vendosje të ankesës.

Më 29 prill 2014, prokurori i shtetit i apelit e ka parashtruar propozimin e vet.

Seanca e kolegjit të Gjykatës së Apelit është mbajtur më 25 qershor 2015. Pasi që shkalla e parë nuk kishte shqiptuar dënim me burgim, në përputhje me nenin 390, § 1 të KPP-së, palëve nuk iu është dërguar njoftimi për seancën.

Kolegji është këshilluar dhe ka votuar më 25 qershor 2015.

## **II. PARASHTRESAT E PALËVE**

### **A. Ankesa e PSRK-së**

PSRK-ja ka bërë ankesë për shkak të:

- shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale;
- shkeljes së ligjit penal; dhe
- vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike,

Dhe i propozon Gjykatës së Apelit anulimin e aktgjykimit të kundërshtuar dhe kthimin e lëndës për rigjykim në Gjykatën Themelore të Gjilanit. Kolegji do t'i diskutojë në hollësi parashtresat e mëposhtme të paraqitura nga PSRK-ja.

### **B. Propozimi i prokurorisë së apelit**

Prokurori i apelit ka paraqitur propozimin që Gjykata e Apelit ta pranojë si të bazuar ankesën e PSRK-së. Prokurori i apelit parashton që analiza dhe vlerësimi i provave i propozuar nga PSRK-ja është e pakontestueshme dhe përmban fakte të mjaftueshme inkriminuese për ta vërtetuar përgjegjësinë penale të të pandehurve për veprën penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit.

## **III. TË GJETURAT E KOLEGJIT**

### **A. Kompetenca**

Në bazë të nenit 472 §1 të KPP-së, kolegji e ka shqyrtuar kompetencën dhe në përputhje me Ligjin mbi gjykatat dhe Ligjin mbi juridiksionin, përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve për gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë, Ligji nr. 03/L-053, i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-273 dhe i sqaruar përmes Marrëveshjes në mes të shefit të EULEX-it në Kosovë dhe të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 18 qershor 2014, kolegji konstaton se EULEX-i ka

juridiksion për këtë lëndë dhe se kolegji është kompetent për të vendosur rreth lëndës në fjalë në përbërje prej dy gjyqtarëve kosovarë dhe një gjyqtari të EULEX-it.

B. Pranueshmëria e ankesës

Ankesa është ushtruar brenda afatit kohor prej 15 ditësh në pajtim me nenin 380 §1 të KPP-së. Kjo ankesë është parashtruar nga personi i autorizuar dhe i përmban të gjitha informatat e tjera në pajtim me nenin 376 *et seq* të KPP-së.

Ankesa është e afatshme dhe e pranueshme.

C. Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

*a. Dispozitivi*

PSRK-ja parashtron se dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i pakuptueshëm, për shkak të kundërshtive dhe mungesave të tij.

Kolegji vëren se lidhur me atë që prokuroria pretendon se është shkelur neni 370 §4 i KPP-së (prokuroria gabimisht i referohet §7 të KPP-së), një gjë e tillë nuk qëndron meqë dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar i plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara me nenin 370 §4 të KPP-së.

Dispozitivi ofron një përshkrim koherent dhe të kuptueshëm të fakteve vendimtare si dhe i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme të përshkruara me nenin 370 §4 të KPP-së, lidhur me nenin 364 të KPP-së. Dispozitivi është plotësisht koherent me arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar dhe i pasqyron të gjeturat e shtjelluara aty. Gjykata Themelore i ka prezantuar arsyet për secilën pikë individuale të vendimit të saj, ashtu siç përcaktohet me nenin 370 §6 të KPP-së.

Dispozitivi i lexuar së bashku me arsyetimin e detajuar të aktgjykimit të kundërshtuar ofron një vlerësim të mjaftueshëm të provave dhe të fakteve, të cilat Gjykata Themelore i ka konsideruar si të provuara dhe të paprovuara. Në përputhje me nenin 370 §7 të KPP-së, Gjykata Themelore po ashtu ka bërë një vlerësim të detajuar të arsyeve të cilat e çojnë Gjykatën Themelore në gjetjen e zgjidhjeve faktike dhe ligjore.

*b. Eksperti i pavarur financiar*

PSRK-ja deklaron se Gjykata Themelore nuk ka ofruar arsyetim të mirëfilltë lidhur me propozimin për caktimin e një eksperti të pavarur financiar.

Kolegji thekson se Gjykata Themelore ka diskutuar dhe ka propozuar caktimin e një eksperti të pavarur financiar gjatë shqyrtimit gjyqësor, porse ishte vetë prokuroria e cila ka kundërshtuar caktimin e tij.<sup>1</sup> Për këtë arsye, parashtesa në fjalë është e pabazë.

#### *c. Vlerësimi i provave*

PSRK-ja deklaron se Gjykata Themelore nuk e ka bërë vlerësimin e provave kundërshtuese. Gjykata Themelore më tutje i ka injoruar provat e shumta inkriminuese dhe është fokusuar vetëm në provat shfajësuese.

Kolegji e konfirmon se Gjykata Themelore në aktgjykimin e kundërshtuar nuk e ka diskutuar në mënyrë të detajuar secilën provë të prezantuar si të tillë. Gjykata Themelore megjithatë e ka diskutuar në detaje çdo situatë dhe çështje specifike që ka të bëjë me të gjitha provat e prezantuara nga prokuroria.

#### *d. Buxheti i komunës*

PSRK-ja pretendon se paragrafi 25 i aktgjykimit të kundërshtuar (versioni në gjuhën angleze) është i pakuptueshëm, sepse së pari e thekson se buxheti komunal është realizuar 100%, ndërsa më tutje në tekst e thekson se disa prej shpenzimeve nuk janë realizuar në mënyrë të plotë.

Kolegji e thekson se edhe pse paragrafi 25 i aktgjykimit të kundërshtuar (versioni në gjuhën angleze) mund të perceptohet si disi i dykuptimtë, prokuroria nuk mendon se kjo sjell ndonjë pasojë juridike konkrete. Sidoqoftë del e qartë nga paragrafi 25 lidhur me raportin financiar për periudhën janar – dhjetor 2009, se buxheti nuk është tejkaluar. Parashtesa në fjalë është e pabazë.

#### *e. Provat e administruara*

PSRK-ja deklaron se palët nuk janë njoftuar me provat e administruara dhe nuk iu është dhënë mundësia që të paraqesin prova të tjera të përcaktuara me nenin 348 të KPP-së. As prokurorit nuk i është dhënë rasti që të bëjë ndonjë vlerësim mbi çështjen nëse konsideron se dokumentet në fjalë janë lexuar.

---

<sup>1</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të Gjykatës Themelore të Gjilanit (PKR 529/13), i seancës së mbajtur më 28 tetor 2013, dosja MT I/6, faqe 2, faqe 4 (versioni në gjuhën angleze).

Kolegji konfirmon se kodi procedural nuk është zbatuar me këtë rast në mënyrë të përpiktë.<sup>2</sup> Megjithatë, prokuroria nuk e ka kundërshtuar rrjedhën e sugjeruar të ngjarjeve dhe me këtë është pajtuar në mënyrë indirekte me procedurën e ndjekur nga Gjykata Themelore. Sidoqoftë, të gjitha palëve iu është siguruar lista e provave me shkrim prandaj kanë qenë në dijeni rreth këtyre provave. Duke e pasur parasysh pëlqimin e të gjitha palëve, duke e përfshirë këtu edhe prokurorinë, lidhur me rrjedhën e ndërmarrë të procedurës së Gjykatës Themelore, kolegji e refuzon parashtresën.

*f. Refuzimi i akuzave*

PSRK-ja deklaron se Gjykata Themelore nuk e ka vlerësuar çështjen thelbësore kur e ka refuzuar akuzën, pasi që është kufizuar vetëm në provat shfaqësuese duke e shkelur kështu nenin 370 §11 të KPP-së.

Duhet të përmendim se neni 370 §11 i KPP-së i referohet aktgjykimit me të cilin refuzohet akuza (në bazë të nenit 363 të KPP-së). Në këtë rast, të pandehurit janë liruar, prandaj neni 370 §11 i KPP-së nuk është i zbatueshëm, rrjedhimisht parashtresa refuzohet.

*g. Nënshkrimi i procesverbaleve*

Sipas PSRK-së, procesverbalet e shqyrtimit gjyqësor nuk janë nënshkruar nga të gjitha palët, siç përcaktohet me nenin 317 të KPP-së.

Kolegji e thekson se procesverbalet në shqip të seancave të shqyrtimit gjyqësor vërtet nuk janë nënshkruar nga të gjitha palët, ndërsa të gjitha palët i kanë nënshkruar procesverbalet e shqyrtimit gjyqësor. Pasi që edhe anglishtja është gjuhë zyrtare në lëndët në të cilat është i përfshirë EULEX-i, atëherë parashtresa në fjalë refuzohet.

**D. Vërtetimi i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike**

PSRK-ja e konteston vërtetimin e gjendjes faktike nga ana e Gjykatës Themelore. Kolegji vëren, megjithatë, se edhe pse prokuroria e konteston vërtetimin e gjendjes faktike në raport me të dy të pandehurit, ajo vetëm i ka prezantuar parashtresat konkrete lidhur me të pandehurin B.S. dhe jo drejtpërdrejt lidhur me të pandehurin H.K..

Kolegji i apelit e përkujton se kur ligji i përcakton shprehjet “vërtetim i gabueshëm i gjendjes faktike” dhe “vërtetim jo i plotë i gjendjes faktike”, ai iu referohet gabimeve apo lëshimeve që

---

<sup>2</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të Gjykatës Themelore të Gjilanit (PKR 529/13), i seancës së mbajtur më 19 nëntor 2013, dosja MT II/29, f. 1 - 2 (versioni në anglishte).

kanë të bëjnë me “faktet materiale” të cilat janë të rëndësishme jetike për vendimin e marrë.<sup>3</sup> Gjykata e Apelit e anulon aktgjykimin vetëm nëse Gjykata Themelore ka bërë ndonjë gabim themelor gjatë vlerësimit të provave dhe gjatë vërtetimit të fakteve.

Si parim i përgjithshëm, vlerësimi i provave duhet të mbështetet në ekzaminimin e menjëhershëm të dëshmimeve verbale dhe të deklaratave nga kolegji i gjyqtarëve. Të lexuarit e procesverbalit të provave të shqyrtuara në gjykim, sado besnik dhe i saktë të jetë ai, është gjithmonë një instrument më pak i besueshëm për vlerësimin e provave. Madje edhe ekzaminimi i dokumenteve dhe i provave të tjera materiale në përgjithësi është më i saktë në gjykim sepse shpesh ato prova duhet të ndërlidhen me elemente të tjera dhe sqarohen me shpjegime verbale të dëshmitarëve apo të palëve të tjera. Prandaj, siç ka vërtetuar kjo gjykatë edhe në rastet e tjera<sup>4</sup>, *“është parim i përgjithshëm i procedurës së apelit që Gjykata e Apelit duhet patjetër ta respektojë gjendjen faktike të konstatuar nga trupi gjykues për shkak se pikërisht ky i fundit ka qenë në pozitë më të mirë për vlerësimin e provave”*. Kjo është në frymën e standardeve të zbatuara nga Gjykata Supreme, pra *“të mos ndryshojë të gjeturat e trupit gjykues, vetëm nëse provat mbi të cilat është mbështetur trupi gjykues janë prova të papranueshme nga çfarëdo gjykate e arsyeshme faktike, apo nëse vlerësimi i saj ka qenë tërësisht i gabueshëm”*.<sup>5</sup>

Duke e pasur këtë parasysh, në aktgjykimin e kundërshtuar kolegji me kujdes i ka analizuar provat në këtë procedurë penale së bashku me arsyetimin e Gjykatës Themelore. Kolegji më tej i ka shqyrtuar me kujdes argumentet e prezantuara në ankesë dhe në propozimin e prokurorisë.

Gjykata Themelore në aktgjykimin e kundërshtuar në mënyrë të detajuar i ka diskutuar akuzat në fjalë. Është evidente se trupi gjykues në mënyrë të arsyeshme i ka analizuar dhe i ka peshuar provat të cilat e përfshijnë secilin të pandehur veç e veç. Duke e pasur parasysh shqyrtimin e provave nga ana e trupit gjykues dhe shpjegimin e tyre në përgjithësi të qartë rreth arsyeve për të gjeturat e tyre, përveç aspekteve të veçanta siç tregohet më poshtë, kolegji i pranon të gjeturat faktike dhe arsyetimin e trupit gjykues. Në përgjithësi, kolegji pajtohet me lirimin e të pandehurve pasi që provat e prezantuara nga prokuroria kryesisht fokusohen në aktet faktike dhe jo në përgjegjësinë penale të të pandehurve. Për këtë arsye, aktet për të cilat akuzohen të pandehurit B.S. dhe H.K., nuk përbëjnë vepër penale prandaj edhe Gjykata Themelore saktë dhe drejt e ka marrë aktgjykimin lirues në përputhje me nenin 364 §1.1 të KPP-së.

Para se të futemi në detaje lidhur me aspekte të caktuara të ngritura nga prokuroria, kolegji së pari konstaton si në vijim: në mënyrë që aktet të përbëjnë vepër penale të shpërdorimit të pozitës

---

<sup>3</sup> B. Petric: Komentim i neneve të Ligjit të Procedurës Penale të Jugosllavisë, botimi i dytë i vitit 1986, neni 366, para. 3.

<sup>4</sup> PAKR 1121/12, Aktgjykimi i datës 25/09/2012.

<sup>5</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 84/2009, 3 dhjetor 2009, paragrafi 35; Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 2/2012, 24 shtator 2012, paragrafi 30.



zyrtare ose autorizimit, neni 339 §1 i KPPK-së e specifikon se këto akte duhet të kryhen me qëllim të përfitimit të dobisë së kundërligjshme pasurore për veten, ose për personin tjetër apo për organizatën afariste ose për t'i shkaktuar dëm personit apo organizatës tjetër afariste. Si vërejtje e përgjithshme, kolegji konstaton se në përgjithësi prokuroria nuk ka ofruar prova të mjaftueshme lidhur me elementin e dashjes në raport me faktet në fjalë. Prokuroria kryesisht është fokusuar në vetë faktet pa ofruar prova të mjaftueshme se të pandehurit në fjalë kanë vepruar me dashjen e përshkruar më sipër. Për më tepër, nuk janë ofruar prova të mjaftueshme lidhur me atë se kush në mënyrë konkrete ka përfituar nga veprimet e tilla. Kolegji, përveç kësaj, vëren se vetë shkëlja e ligjit administrativ nuk nënkupton vetvetiu përgjegjësi penale, ngase prova të tjera duhet të prezantohen lidhur me elementet e përmendura më sipër.

*a. Buxheti vjetor i komunës*

PSRK-ja pohon se Gjykata Themelore e ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike duke ardhur tek përfundimi se komuna nuk e ka tejkalluar buxhetin e saj vjetor. Gjykata Themelore e ka harruar faktin se në fund të vitit 2009, komuna në fjalë nuk e ka larë borxhin ndaj kompanive, në vlerë prej mbi 300.000 eurosh. Një borxh i tillë është zgjidhur përmes procedurave gjyqësore, përmes të cilave komuna është obliguar që të paguajë norma të larta të interesit, duke iu shkaktuar kështu komunës një dëm i madh nga të pandehurit.

Kolegji vëren se edhe pse mund të ketë indikacione për një praktikë të keqe të menaxhimit të buxhetit, vetë fakti se ka pasur borxhe nuk provon që të pandehurit kanë vepruar me dashje për t'i shkaktuar ndonjë dëm personit apo organizatës tjetër afariste.

*b. Qytetarët nevojtarë*

PSRK-ja pretendon se nuk është e vërtetë se për ndihmën e ndarë nga i pandehuri B.S., kishte pasur kërkesa nga qytetarët nevojtarë, për shkak se një dokument i lëshuar nga vetë komuna i datës 1 tetor 2013, i konfirmuar nga dëshmitari V.K., provon se nuk ka pasur kërkesa të tilla. Për më tepër, në asnjërin prej vendimeve të marra nga i pandehuri B.S., nuk ishin të përfshirë emrat konkretë të personave të varfër të cilët do të përfitonin.

Kolegji konstaton se edhe pse personat e varfër nuk kishin bërë asnjë kërkesë specifike për ndihmë, prapë ishin sjellë vendimet për mbështetjen e tyre me emra të përmendur.<sup>6</sup> Për më tepër, prokuroria nuk ka prezantuar prova lidhur me atë se nuk janë harxhuar para për sigurimin e ndihmave për të varfrit ose se vetë të pandehurit kanë pranuar para. Prandaj, nuk ka prova që të pandehurit kanë vepruar me dashje për të përfituar dobi të kundërligjshme pasurore për veten apo për ndonjë person apo organizatë afariste tjetër.

---

<sup>6</sup> Dosja e mbrojtjes nr. 23 & dosja e provave financiare nr. 8 (versioni në gjuhën angleze).

### *c. Procedura e prokurimit*

PSRK-ja pretendon se kontrata e nënshkruar në mes të komunës së Kamenicës dhe të kompanisë Goni nuk ka kaluar nëpër procedurën e prokurimit. Ndhimat janë ndarë duke u bazuar në kontratën e vitit 2009 dhe jo në atë të vitit 2007. Sa i përket çështjes se një numër i madh shpenzimesh nuk i janë nënshtruar procedurës së prokurimit, të pandehurit kanë pretenduar se ligji mbi prokurimin i përcakton përjashtimet, por neni 3 i Ligjit nr. 2009/03-L-158 në mënyrë të qartë i definon rastet kur mund të ketë përjashtime, dhe në këtë rast këto përjashtime nuk kanë të bëjnë asgjë me veprimet e të pandehurve në fjalë.

Kolegji vëren se procedura e prokurimit për vitin 2009, të cilin e ka ndjekur komuna e Kamenicës mbase nuk ka qenë në përputhje të plotë me Ligjin nr. 2009/03-L-158, por kjo gjë megjithatë nuk nënkupton automatikisht përgjegjësi penale. Edhe pse mund të jetë praktikë e keqe, vetë fakti që disa prej procedurave të prokurimit mund të mos jenë zbatuar në mënyrë rigorozë nuk provon se të pandehurit kanë vepruar me dashjen e përfitimit të një dobie të kundërligjshme pasurore për veten apo për personin apo organizatën tjetër afariste ose me dashjen e shkakimit të dëmit personit apo organizatës tjetër afariste.

### *d. Ligji mbi zgjedhjet*

PSRK-ja thekson se janë shkelur dispozitat e neneve 2 dhe 35 të Ligjit mbi zgjedhjet, me rastin e shpërndarjes së ndihmave.

Kolegji thekson se prokuroria në ankesën e tyre nuk i ka shtjelluar më tej arsyet për shkeljen në fjalë të neneve 2 dhe 35 të Ligjit mbi zgjedhjet dhe nuk i është referuar kësaj pike me asnjë provë përkatëse. Kolegji për këtë arsye e konsideron të paqëndrueshme këtë parashtrësë.

### *e. Përdorimi i veturës*

PSRK-ja deklaron se Gjykata Themelore ka vërtetuar gabimisht kur ka pohuar se vetura e të pandehurit B.S. ishte përdorur për qëllime zyrtare. Nuk është e vërtetë se komuna nuk kishte vetura të mjaftueshme, për shkak se gjatë gjykimit është vërtetuar se komuna kishte dhënë donacion veturat e veta dhe raporti financiar për periudhën janar – dhjetor 2009, në faqen 12, provon se komuna kishte një numër të madh veturash dhe shuma të mëdha parash ishin shpenzuar për regjistrimin e tyre. Prandaj, nuk kishte nevojë që i pandehuri ta shfrytëzonte veturën e tij private për qëllime zyrtare.

Kolegji konstaton se provat e prezantuara nga prokuroria nuk provojnë se i pandehuri B.S. nuk e kishte shfrytëzuar veturën e tij private për qëllime zyrtare. Vetë fakti se komuna ka mund të ketë vetura të tjera në dispozicion nuk e provon se i pandehuri B.S. nuk e kishte shfrytëzuar veturën e

tij për qëllime zyrtare. Prandaj nuk ka prova se i pandehuri B.S. kishte vepruar me dashjen e përshkruar më lart.

*f. Karburantet*

PSRK-ja deklaroi se dëshmitari A.K. kishte deklaruar se gjatë periudhës kohore 8 shtator 2011 – 8 tetor 2013 nuk kishte pasur ndërprerje të shpeshta të energjisë elektrike; shih po ashtu listën mujore të punës së gjeneratorit e cila është bashkëngjitur në provat për karburantet nga data 21 dhjetor 2012. Prandaj, nuk qëndron konstatimi se gjatë asaj periudhe kohore ka pasur ndërprerje të shpeshta të energjisë elektrike. Për më tepër, shpenzimet për karburante janë parashikuar të jenë në shumën prej 8.275,00 eurosh për zyrën e kryetarit të komunës dhe për asamblenë komunale, përderisa vetëm zyra e kryetarit të komunës e kishte tejkaluar shumën e parashikuar në fjalë. Gjithashtu, shumat e larta të shpenzimeve të bëra janë të kontestueshme, duke e pasur parasysh atë çfarë deklaroi dëshmitari A.K.2 se nuk janë harxhuar më shumë sesa 230 litra karburante, përderisa shpenzimet e bëra për to kishin arritur shumën prej mbi 12.000 eurosh, shih po ashtu edhe dëshminë e dëshmitarit A.K.2, të dhënë gjatë gjykimit më 9 tetor 2013.

Për më tepër, gjykata ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike kur e ka specifikuar se vetëm një person i cili nuk ishte punonjës i administratës komunale kishte pranuar karburante nga buxheti komunal, nga lista e shpenzimeve për karburante për vitin 2009, është konstatuar se edhe persona të tjerë si J.S., A.A. e po ashtu edhe të tjerë, të cilët nuk punonin për administratën komunale, në disa raste kishin pranuar furnizime me karburant, të paguara nga buxheti i komunës së Kamenicës.

Kolegji konstaton për ndryshim nga parashpresa e prokurorit se nuk ka prova që nuk ka pasur ndërprerje të energjisë elektrike. Dëshmitari A.K. në mënyrë të qartë thekson se vërtet ka pasur ndërprerje të energjisë elektrike.<sup>7</sup> Për më tepër, ky dëshmitar po ashtu thekson se lista e punës së gjeneratorit nuk është përditësuar, pasi që disa prej fletëve të saj mungojnë dhe sistemi automatik për monitorimin e përdorimit të gjeneratorit nuk ka punuar, prandaj mungon pasqyra e qartë e konsumimit të karburantit të gjeneratorit.<sup>8</sup> Për më tepër, ai thekson se kishte më shumë persona të autorizuar për furnizim të gjeneratorit me karburant dhe për ta ndezur. Edhe pse një gjë e tillë mund të jetë një praktikë e keqe, kjo gjë nuk provon se të pandehurit kanë vepruar me dashje të përfitimit të dobisë së kundërligjshme pasurore për vete apo për ndonjë person apo organizatë tjetër afariste ose me dashje të shkaktimit të dëmit personit apo organizatës tjetër afariste.

---

<sup>7</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të Gjykatës Themelore të Gjilanit (PKR 529/13) i seancës së mbajtur më 8 tetor 2013, dosja MT I/12, faqe 4-7 & dosja nr. 5 e marrjes në pyetje të dëshmitarit në procedurën paraprake, faqe 3 (në versionin në gjuhën angleze)

<sup>8</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të Gjykatës Themelore të Gjilanit (PKR 529/13) i seancës së mbajtur më 8 tetor 2013, dosja MT I/12, faqe 6 (në versionin në gjuhën angleze).

Sa i përket planit të shpenzimeve, kolegji vëren se Gjykata Themelore në aktgjykimin e kundërshtuar ka përcaktuar drejt vlerën provuese penale të planeve të tilla. Vetë fakti se një plan i shpenzimeve ka mundur të tejkalohet nuk nënkupton automatikisht përgjegjësi penale. Po ashtu edhe në këtë rast mund të jetë praktikë e keqe, por kjo gjë megjithatë nuk provon se të pandehurit në fjalë kanë vepruar me qëllim të përfitimit të dobisë së kundërligjshme pasurore për veten apo për personin ose organizatën tjetër afariste ose me dashje të shkaktimit të dëmit personit apo organizatës tjetër afariste.

Lidhur me deklaratën e dëshmitarit A.K.2, kolegji e vëren se deklarata e tij nuk ofron prova të mjaftueshme se shpenzimet e deklaruara nuk përputhen me sasinë e vërtetë të karburantit të harxhuar. Siç ka deklaruar edhe vetë A.K.2, ai thjesht e ka dhënë një vlerësim të pjesshëm duke u mbështetur në prova jozyrtare. Prandaj, mungojnë provat e mjaftueshme që shpenzimet e deklaruara nuk përputhen me sasinë e vërtetë të karburantit të shpenzuar.

Lidhur me konsumimin e pohuar të karburantit nga J.S. dhe A.A.2, kolegji vëren se nuk është provuar mjaftueshëm se karburanti nuk është harxhuar në interes të komunës. Qëllimi i shfrytëzimit të karburantit nga këta persona nuk është i qartë, por nuk është dhënë asnjë provë për ta provuar keqpërdorimin e tij. Vetë fakti se ata nuk kanë qenë punonjës së komunës nuk mundëson konkluzione rreth dashjes së këtyre të pandehurve.

#### *g. Planifikimi i prokurimit*

PSRK-ja deklaron se Gjykata Themelore ka bërë një vërtetim të gabueshëm kur ka konstatuar se planifikimi i prokurimit përfundimtar ishte i parëndësishëm, duke e parë se ishte miratuar nga organet kompetente dhe ishte vërtetuar se planifikimi mund të ketë variacion prej jo më shumë sesa 5%, përderisa në rastin në fjalë shpenzimet kanë qenë katër herë më të larta dhe atë pa procedura prokurimi.

Kolegji vëren se pohimi i prokurorisë se planifikimi i prokurimit nuk mund të ketë variacion më të madh sesa 5% nuk ka vlerë provuese penale; nëse ka fare ndonjë implikim juridik. Dëshmitari I.A. e ka përmendur variacionin prej 5% pa e mbështetur këtë përqindje në ligjet materiale, por vetëm duke theksuar se një variacion i këtillë mbështetet në studimet e tija universitare.<sup>9</sup> Siç është theksuar edhe në rrethanat e tjera, tejkalmi i planifikimit mund të shënojë një praktikës të keqe, por kjo megjithatë nuk provon se të pandehurit kanë vepruar me dashje për të përfituar ndonjë dobi të kundërligjshme pasurore për veten apo për personin ose organizatën tjetër afariste apo me dashje të shkaktimit të dëmit personit apo organizatës tjetër afariste.

---

<sup>9</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të Gjykatës Themelore të Gjilanit (PKR 529/13) i seancës së mbajtur më 8 tetor 2013, dosja MT I/15, faqe 4 (në versionin në gjuhën angleze).

#### *h. Auditimi i brendshëm*

PSRK-ja pretendon se raportet e siguruara nga auditorët e pavarur dhe nga auditori i brendshëm komunal kanë vërtetuar drejt të gjitha shkeljet e ligjit të kryera nga të pandehurit në vitin 2009. Shkeljet në fjalë po ashtu janë pohuar edhe nga shumica e dëshmitarëve, në veçanti nga R.H., I.A. dhe S.S.. Për më tepër, Gjykata Themelore ka bërë gabim të rëndë kur ka konstatuar se dëshmitë e R.H.t dhe të S.S.t nuk ishin të besueshme.

Edhe një herë kolegji duhet patjetër të theksojë se edhe pse raportet e siguruara nga auditorët e pavarur mund të përbëjnë një praktikë të keqe e komunës së Kamenicës në vitin 2009, këto raporte nuk përmbajnë prova të mjaftueshme për përgjegjësinë penale të të pandehurve lidhur me dashjen për të përfituar dobi të kundërligjshme për veten apo për personin ose organizatën tjetër afariste apo me dashje të shkaktimit të dëmit personit apo organizatës tjetër afariste.

Sa i përket deklaratës së ofruar nga S.S., kolegji pajtohet plotësisht me vlerësimin e deklaratës së tij nga Gjykata Themelore, në mënyrë më konkrete të adresuar në paragrafin 66 të aktgjyqimit të kundërshtuar (radhitja e faqeve sipas versionit në anglishte). Ndërkaq sa i përket dëshmitarit R.H., kolegji vëren se prokuroria me të drejtë ka pohuar se Gjykata Themelore nuk e ka vlerësuar këtë dëshmitar në aktgjykimin e kundërshtuar. Kolegji, prandaj ka vlerësuar me kujdes deklaratat e dëshmitarit R.H.. Ai i ka përshkruar vërejtjet e tija sa iu përket përdorimit të fondeve komunale. Kolegji megjithatë konstaton se dëshmia e tij nuk përmban prova të mjaftueshme për ta provuar përgjegjësinë penale të të pandehurve. Për më tepër, nuk janë marrë prova të cilat i mbështesin pohimet e tij.

Sa i përket dëshmitarit I.A., kolegji po ashtu vëren se Gjykata Themelore nuk e ka vlerësuar këtë dëshmitar në aktgjykimin e kundërshtuar. Informatat e dhëna nga dëshmitari I.A. po ashtu gjenden edhe në raportet e auditorit. Megjithatë, kolegji i ka vlerësuar me kujdes deklaratat e dëshmitarit I.A. dhe ka gjetur se dëshmia e tij nuk përmban prova të mjaftueshme për të provuar se të pandehurit e kanë kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autorizimit zyrtar. Dëshmitari I.A. nuk e përmend se sistemi i komunës së Kamenicës kishte defekte dhe prishje të kohëpaskohshme, të cilat ai i ka përshkruar si “dështim të sistemit”, megjithatë nuk ka ofruar prova konkrete për përgjegjësinë e të pandehurve.<sup>10</sup>

#### *i. Vlerësimi i provave dhe dëshmitëve të të pandehurve*

PSRK-ja pretendon se Gjykata Themelore i ka marrë parasysh të gjitha provat shfajësuese, por se nuk i ka analizuar dhe nuk i ka marrë parasysh provat fajësuese pa dhënë arsytimin pse ka vepruar kështu. Më tutje theksohet se Gjykata Themelore nuk e ka vërtetuar se cilat prova të tjera

---

<sup>10</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të Gjykatës Themelore të Gjilanit (PKR 529/13) i seancës së mbajtur më 8 tetor 2013, dosja MT I/15, faqe 6 (në versionin në gjuhën angleze).

të administruara nga gjykata i vërtetojnë deklaratat e të pandehurve, të cilat Gjykata Themelore i ka konstatuar të besueshme përkundër faktit se të pandehurit kurrë nuk e thonë të vërtetën. Dëshmitë e tyre kanë ra në kundërshtim me shumë prova të shkruara, por Gjykata Themelore nuk i ka marrë fare parasysh këto prova.

Kolegji nuk pajtohet me pohimin e prokurorisë se Gjykata Themelore nuk i ka vlerësuar si duhet të gjitha provat. Kolegji me kujdes i ka shqyrtuar dhe i ka vlerësuar provat e prezantuara nga prokuroria duke konstatuar se Gjykata Themelore në mënyrë të mjaftueshme i ka adresuar dhe i ka vlerësuar çështjet dhe rrethanat e ngritura nga prokuroria. Kolegji në tërësi pajtohet me analizën e Gjykatës Themelore. Qëndrimi i prokurorit me të cilin ai i përjashton deklaratat e të pandehurve me arsyetimin se “ata kurrë nuk e thonë të vërtetën” është i papranueshëm. Gjykata Themelore e ka përshkruar vlerësimin e provave të dokumentuara në faqen 64 të aktgjykimit, duke i përmendur provat e posaçme në pikat e mëhershme. Prokurori i shtetit, përkundrazi, nuk përmend asnjë provë konkrete, e cila nuk është marrë në konsideratë, duke ndikuar në konkluzione të gabuara të gjykatës.

#### *j. Ndihma*

PSRK-ja pretendon se pikat 61 dhe 77 të aktgjykimit të kundërshtuar tregojnë se aktgjykimi bie në kundërshtim me veten. Pika 61 e specifikon emrat e personave të varfër nuk janë përmendur në vendime, përderisa pika 77 e specifikon se nuk do të ishte e logjikshme të besohet se i pandehuri B.S. do të ofronte ndihmë pa pasur kurrfarë kërkesë për të. Për më tepër, nëse ndihma në fjalë vërtet është ofruar, kjo ndihmë është ofruar në përpjekje për të pasur ndikim në zgjedhjet, pasi që 90% e ndihmës së ofruar ishte ndarë gjatë katër muajve të fundit të vitit 2009, ndërsa në vitin 2008 nuk ishte ndarë fare.

Siç vërehet nën paragrafin B ‘Qytetarët në nevojë’ të këtij aktgjykimi, prokuroria nuk kishte prezantuar prova se paratë në fjalë nuk iu ishin dhënë të varfërve. Për më tepër, i pandehuri B.S. si kryetar i komunës së Kamenicës nuk ka shkuar përtej mandatit kur iu kishte ofruar ndihma të varfërve, pavarësisht nëse një ndihmë e këtillë ishte ofruar gjatë periudhës së fundit të mandatit të tij apo jo. Gjithashtu nuk ka pasur prova se pranuesit e ndihmës nuk kanë qenë të varfër, apo se kanë qenë të ndikuar për të votuar në zgjedhjet komunale. Parashtrësja e prokurorisë prapë nuk e provon përgjegjësinë penale të të pandehurve.

#### *k. Shujtat e restorantit*

PSRK-ja parashtron që Gjykata Themelore ka vërtetuar gabimisht që Policia e Kosovës i kanë ngrënë shujtat e tyre në restorant, kur në fakt këto shujta ata i kanë marrë në pozitat e tyre përkatëse dhe jo në restorant. Më tutje, shpenzimet e shkaktuara nga policia ditën e zgjedhjeve

kanë qenë shumë të larta nëse krahasohen me shujta bile edhe po të kishin shkuar në restorantet e pohuara.

Kolegji vëren se Gjykata Themelore nuk e ka vërtetuar se policët kanë ngrënë në restorant, porse Gjykata Themelore thjesht e ka vërtetuar se këta policë janë shërbyer nga restoranti në fjalë. Për më tepër, prokuroria nuk e ka ofruar asnjë provë konkrete me të cilën do të tregonte se policët nuk janë shërbyer me këto shujta, por prokuroria mbështetet vetëm në deklaratat boshe sepse dihet mirë se çfarë ushqimi iu shërbehet policëve ditën e zgjedhjeve. Përkundrazi, dëshmitari L.P., komandant i policisë në Kamenicë, ka deklaruar se policëve iu është shërbyer ushqimi në fjalë dhe se vetë ai ka kërkuar nga kryetari i komunës që t'i mbulojë shpenzimet për këtë ushqim.

<sup>11</sup> Edhe një herë, parashtresa e prokurorisë nuk e provon përgjegjësinë kriminale të të pandehurve.

#### *l. Fushata zgjedhore, pllakatet*

PSRK-ja parashton se fakti që gjatë zgjedhjeve, fotografitë e të pandehurit B.S. dhe të atyre kandidatëve të tjerë nga partia e tij janë reklamuar duke e shfrytëzuar buxhetin komunal, është verifikuar me dëshminë e dëshmitarit V.K.; megjithatë, ai e kishte ndryshuar këtë dëshmi në gjykatë. Një fakt i tillë, po ashtu është verifikuar edhe me deklaratën e dhënë më 14 nëntor 2013 nga organet kompetente të komunës së Kamenicës, duke provuar se në katër muajt e parë të vitit 2009, nuk është reklamuar asnjë projekt komunal. Fakti pse gjykata nuk e ka shqyrtuar këtë provë mbetet i panjohur.

Kolegji vëren se nuk ka ndonjë lidhje konkrete në mes të reklamave për zgjedhje dhe shpenzimeve të buxhetit të komunës së Kamenicës nga të pandehurit në fjalë. Asnjë prej pllakateve të përmendura nuk i përmend apo tregon të pandehurit apo çfarëdo informate që lidhet me ta. Për këtë shkak mungojnë provat e mjaftueshme se të pandehurit kanë dashur të përfitojnë dobi të kundërligjshme pasurore për veten apo për personin apo organizatën tjetër afariste apo kanë dashur t'i shkaktojnë dëm personit apo organizatës tjetër afariste.

#### *m. Eksperti i pavarur financiar*

PSRK-ja parashton se Gjykata Themelore ka bërë gabim kur nuk e ka miratuar propozimin për caktimin e një eksperti të pavarur financiar, pasi që një ekspert i tillë do ta kishte verifikuar situatën e vërtetë rreth kësaj çështjeje.

---

<sup>11</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të Gjykatës Themelore të Gjilanit (PKR 529/13) i seancës së mbajtur më 8 tetor 2013, dosja MT I/11, faqe 3 - 5 (në versionin në gjuhën angleze).

Siç është theksuar edhe më herët, Gjykata Themelore e ka diskutuar propozimin e mbrojtjes për caktimin e një eksperti të pavarur financiar gjatë shqyrtimit gjyqësor, porse kanë qenë vetë prokuroria e cila e kanë kundërshtuar caktimin e tij. Për këtë arsye, parashtrësja e prokurorisë është e pabazë.

#### *n. Konkluzion*

Kolegji e përsërit edhe një herë se Gjykata Themelore në aktgjykimin e saj të kundërshtuar në mënyrë të detajuar i ka diskutuar akuzat e pohuara. Kolegji më tutje e pranon gjendjen faktike dhe arsyetimin e trupit gjykues, siç është shtjelluar më lart. Kolegji për më tepër, pajtohet me konkluzionin e Gjykatës Themelore që prokuroria nuk ka prezantuar prova konkrete rreth përgjegjësisë penale të të pandehurve lidhur me atë se të pandehurit kanë dashur të përfitojnë dobi të kundërligjshme pasurore për veten apo për personin apo organizatën tjetër afariste apo kanë dashur t'i shkaktojnë dëm personit apo organizatës tjetër afariste, prandaj këto prova mungojnë. Aktet për të cilat të pandehurit B.S. dhe H.K. akuzohen prandaj nuk përbëjnë veprë penale dhe për këtë arsye Gjykata Themelore ka sjellë aktgjykim të drejtë dhe të duhur për lirim të tyre.

Edhe pse Gjykata Themelore në dispozitivin e saj në mënyrë të gabueshme e ka përmendur se aktet e kryera nuk janë provuar, është e qartë nga arsyetimi i saj, në veçanti nga paragrafi 90 se të pandehurit janë liruar në bazë të nenit 364 §1.1 të KPP-së, sepse këto akte për të cilat ata akuzohen nuk përbëjnë fare veprë penale.

#### E. Shkelja e ligjit penal në bazë të nenit 385 të KPP-së

PSRK-ja e thekson se sikur të ishin vlerësuar si duhet dëshmitë e dëshmitarëve dhe provat materiale nga ana e Gjykatës Themelore, atëherë nuk do të kishte pasur asnjë dyshim se të pandehurit në fjalë e kanë kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autorizimit zyrtar. Në këtë mënyrë ligji penal është shkelur.

Kolegji konstaton se prokuroria në ankesën e saj nuk i ka shtjelluar më tutje se çfarë shkelje të nenit 385 të KPP-së janë bërë. Nuk është përmendur asnjë paragraf konkret i nenit 385 të KPP-së. Kolegji, për këtë arsye, konstaton se parashtrësja në fjalë është e pabazë.

#### F. Vërejtjet përfundimtare

Gjykata e Apelit – për arsyet e përmendura më sipër – e refuzon ankesën në fjalë dhe e vërteton aktgjykimin e kundërshtuar.



*Aktgjykimi i arsytuar me shkrim është përfunduar më 31 korrik 2015.*

Kryetari i kolegjit

---

Xhevdet Abazi  
Gjyqtar kosovar

Anëtarja e kolegjit

---

Tonka Berishaj  
Gjyqtare kosovar

Anëtari i kolegjit

---

Roman Raab  
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtës

---

Alan Vasak  
Zyrtar ligjor i EULEX-it

---

**Gjykata e Apelit**  
Prishtinë

**PAKR 234/14**  
*25 qershor 2015*